

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

DHE

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**NË FUSHËN E NJOHJES DHE NJËSIMIT RECIPROK TË DIPLOMAVE,
CERTIFIKATAVE DHE GRADAVE SHKENCORE, TË LËSHUARA NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË
AUTORIZUARA**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës dhe
Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje të referuara si “Palët”),

Të shtyrë nga dëshira dhe nevoja për të udhëhequr bashkëpunim produktiv të ndërsjellë në sferën
e njohjes dhe njësimit reciprok të diplomave, certifikatave, të lëshuara nga institucionet e arsimit
të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara,

Duke respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës,
Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizën e Kualifikimeve të Kosovës, Kornizën Evropiane
të Kualifikimeve dhe parimet e standardet ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar
në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh vlerat dhe interesat e përafërta, si dhe duke konsideruar nevojën e
bashkëpunimit dypalësh në fushën e njohjes reciproke të diplomave, mbi bazën e barazisë dhe të
përfitimit të ndërsjellë,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi institucional në fushën e njohjes së diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë të fituara në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, mes zyrave ENIC/NARIC, me qëllim lehtësimin e procedurave të njohjes dhe njësimit.

Termi “diplomë” nënkupton çdo dokument të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi të secilës Palë që dëshmon përfundimin me sukses të një programi studimi ose arritjen e një kualifikimi që i përket nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, pavarësisht emërimit të dokumentit.

Termi “certifikatë” nënkupton çdo dokument të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi të secilës Palë, që dëshmon përfundimin me sukses të një programi studimi ose arritjen e një kualifikimi që i përket nivelit 5.

Termi “gradë shkencore” nënkupton kualifikimin “Doktor” që dëshmon përfundimin me sukses të një programi studimi ose arritjen e një kualifikimi, që i përket nivelit 8 sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 Institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të diplomave (përveç gradës shkencore “Doktor”) të fituara jashtë vendit është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të gradës shkencore “Doktor” të fituar jashtë vendit është Ministria e Arsimit dhe Sportit. Sekretariati teknik për këtë shërbim ndodhet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Kosovës të diplomave dhe certifikatave të fituara jashtë vendit është Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC), në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

Neni 3 Fushëveprimi

Bashkëpunimi institucional në fushën e njohjes dhe njësimit reciprok të diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë do të realizohet me anë të:

- a. Bashkëpunimit në lehtësimin e njohjes dhe njësimit të diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë të fituara në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.
- b. Shkurtimin e afateve reciproke të procedurave të njohjes dhe njësimit të diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të arsimit të lartë, të fituara në dy vendet.

Neni 4

Lehtësimi i procedurave dhe afateve

- a. Për diplomat e lëshuara nga institucionet publike të arsimit të lartë të pajisura me vulë apostile, komisionet përkatëse të njohjes dhe njësimit të diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore procedojnë direkt me njohjen dhe njësimin, pa pasur nevojë për verifikimin me e-mail të autenticitetit të diplomës. Përrjashtimisht, në rastet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm për autenticitetin e dokumentacionit, secila palë ruan të drejtën të kërkojë në rrugë elektronike konfirmimin nga pala tjetër.
- b. Për diplomat, certifikatat dhe gradat shkencore e lëshuara nga institucionet jo-publike/private të arsimit të lartë të pajisura me vulë apostile, konfirmimi i autenticitetit të diplomës dhe detaje të tjera, të kryhet në rrugë elektronike.
- c. Të dyja vendet të pranojnë dokumentacionin e aplikimit të përkthyer dhe noterizuar në vendet respektive, në rast se dokumentacioni nuk është në gjuhën shqipe. Në rast se dokumentacioni është në gjuhën shqipe, paraqitet kopja e njësuar me origjinalin.
- d. Afati për konfirmimin e autenticitetit të diplomës është deri në 14 ditë pune pas paraqitjes së kërkesës nga pala tjetër.
- e. Afati për përfundimin e procesit të njohjes dhe njësimit të diplomës është deri në 20 ditë pune, pas konfirmimit të autenticitetit të diplomës apo paraqitjes së saj me vulën apostile.

Neni 5

Zbatimi i Marrëveshjes

Bashkëpunimi i përcaktuar me këtë Marrëveshje do të zbatohet në pajtim me legjislacionin në fuqi të të dy vendeve, si dhe sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, anëtare të së cilave janë Palët.

Neni 6

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë trevjeçare dhe rinovohet automatikisht për periudhën pasuese trevjeçare, nëse asnjëra prej Palëve nuk e njofton Palën tjetër, me shkrim, për ndërprerjen e saj, të paktën gjashtë muaj para afatit të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.


Neni 7
Hyrja në fuqi dhe plotësim ndryshimi

- a. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Palët.
- b. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve.

Nënshkruar në Tiranë, më 26.11. 2021, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëllë të vlefshëm.

**Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së
Kosovës**

Znj. Arbërie NAGAVCI



**Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të
Republikës së Shqipërisë**

Znj. Evis KUSHI

